



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 406/2 Prot.

Tiranë, më 25.05.2021

**V E N D I M**

Nr.59, datë 25.05.2021

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 456, datë 11.1.2021, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit \*\*\*\*\* dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 406 prot., datë 12.3.2021, nga nëpunësi doganor \*\*\*\*\*, është ngritur pretendimi se, transferimi i tij i përkohshëm për nevoja të institucionit, fillimisht në pozicionin “Përgjegjës Zyre, në Terminalin e Trageteve, Sektori i Operacioneve Doganore në Terminalin e Trageteve, Anijeve, Kontenierët”, Dega Doganore Durrës, dhe më pas në pozicionin “Specialist/Kordinator me DPD”, po në Degën Doganore Durrës, është në tejkalim të afatit 6-mujor që përcakton ligji në rastin e transferimit të përkohshëm, prandaj ai duhet të kthehet në vendin e punës. Për më tepër, pretendohet se, në transferimin e fundit është mbajtur në punë jashtë strukturës, pasi nga 2 pozicione “Specialist/Kordinator me DPD” që ka struktura, aktualisht, janë të punësuar për të kryer këtë detyrë 3 punonjës.

Nga hetimi administrativ i kryer në këtë rast dhe pas analizës së dokumentacionit të çështjes, rezulton e vërtetuar që: Nëpunësi doganor \*\*\*\*\*, është nëpunës civil, i emëruar nga Departamenti i Administratës Publike, me aktin nr. 5226/1, datë 10.9.2019, në pozicionin *“Përgjegjës Turni në Sektorin Operacional/Terminal”*, Dega Doganore Rinas dhe mbi këtë bazë, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave ka nxjerrë aktin nr. 22713/1, datë 18.9.2019, për emërimin e tij në pozicionin e mësipërm.

Veprimet në këtë rast, janë kryer nëpërmjet zhvillimit të procedurave për lëvizjen paralele, në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr.102/2014, *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, neni 13, pika 3, ku parashikohet ndërmjet të tjerave se, lëvizja paralele në administratën doganore për pozicionet e punës që përfshihen në shërbimin civil, bëhet sipas parimeve të këtij kodi, mbi bazën e procedurës të përcaktuar në nenin 15, pika 5, të ligjit, si dhe në Kreun II e IV, të Vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për personelin e administratës doganore”*, i ndryshuar, harmonizuar me parimet dhe përcaktimet e legjislacionit të shërbimit civil.

Pasi ka marrë emërimin e përhershëm në pozicionin *“Përgjegjës Turni në Sektorin Operacional/Terminal”*, Dega Doganore Rinas, rezulton se për nevoja të institucionit, me aktin nr.17114, datë 15.9.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, punonjësi në fjalë, është transferuar përkohësisht në pozicionin *“Përgjegjës Zyre, në Terminalin e Trageteve, Sektori i Operacioneve Doganore në Terminalin e Trageteve, Anijeve, Kontenierët”*, Dega Doganore Durrës. Në këtë akt nuk është shënuar koha e saktë e zgjatjes së këtij transferimi, por prezumohet se ai nuk mund të jetë më shumë se gjashtë muaj, sipas kufizimit të bërë në pikën 7/a, të nenit 15, të Kodit Doganor.

Kërkuesi ka punuar në pozicionin e mësipërm për afro 4 muaj, deri kur me aktin tjetër të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, nr. 456, datë 11.1.2021, ai është transferuar përsëri, në mënyrë të përkohëshme, përsëri pa përcaktuar kohën e saktë, në pozicionin *“Specialist/Kordinator me DPD”*, Dega Doganore Durrës (ku vazhdon të punojë aktualisht).

Nëpunësi doganor \*\*\*\*\*, me pretendimin që, duke nisur llogaritjen e afatit në mënyrë kumulative, nga momenti i transferimit të tij të parë (15.9.2020) është plotësuar afati 6-mujor i parashikuar nga ligji, nëpërmjet një kërkesë drejtuar titullarit të institucionit, ka kërkuar kthimin e tij në pozicionin e mëparshëm të punës *“Përgjegjës Turni në Sektorin Operacional/Terminal”*, Dega Doganore Rinas, kërkesë të cilës, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, i është përgjigjur se transferimi është kryer në zbatim të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe kërkesave specifike të Kodit Doganor në lidhje me transferimin e përkohshëm të punonjësve doganorë, duke nënvizuar se, problemi do të ndiqej në vijimësi nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit brenda afateve që përcaktojnë këto akte ligjore (shkresa kthim përgjigje nr.4045/1, datë 5.3.2021).

Duke mos qenë dakord me këtë qëndrim të institucionit, punonjësi në fjalë, ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë dhe kthimin e tij në vendin e punës si “Përgjegjës Turni në Sektorin Operacional/Terminal”, Dega Doganore Rinas, ku ka emërimin e rregullt.

Në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së dy akteve të transferimit të përkohshëm në këtë rast, që në çastin e parë evidentohet fakti që, për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, në legjislacionin specifik të tij (pika 3 e nenit 13, të Kodit Doganor), janë parashikuar rregulla të posaçme, si në drejtim të llojeve të transferimeve, periodicitetit të tyre ashtu dhe të organit kompetent që urdhëron këto transferime.

Konkretisht, pika 7, e nenit 15, të këtij kodi, në shkronjën “a” parashikon: “Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njëjtës kategori, apo në një kategori më të lartë, për këto arsye dhe kohëzgjatje:

- i) në interes të institucionit, deri në 6 muaj;
- ii) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj;
- iii) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzanisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës.

Siç shihet, në gurmën “i”, të nenit 15, pika 7/a, të ligjit 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është evituar kufizimi i dispozitës së ngjashme të pikës 1/a, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas së cilës lejohet të bëhet një transferim i përkohshëm i një nëpunësi deri në 6 muaj (njëherësh ose e copëzuar) për nevoja të punës, por kjo jo më shumë se një periudhë 6-mujore, gjatë dy viteve.

Kjo, në kuptimin literal të dispozitës së Kodit Doganor, do të thotë që, një nëpunës doganor, mund të transferohet përkohësisht për nevoja të institucionit, sa herë lind e nevojshme, pa patur ndonjë kufizim ligjor në shpeshhtësi, prandaj transferimi i përkohshëm, i njëpasnjëshëm, i këtij punonjësi doganor, në pozicionet “Përgjegjës Zyre, në Terminalin e Trageteve, Sektori i Operacioneve Doganore në Terminalin e Trageteve, Anijeve, Kontenierët”, Dega Doganore Durrës dhe “Specialist/Kordinator me DPD”, Dega Doganore Durrës, është formalisht i ligjshëm, pasi llogaritja e afatit maksimal 6 mujor, në çdo rast të ri, fillon nga momenti i daljes së secilit urdhër transferimi.

Nisur nga kuptimi i mësipërm i dispozitës, afati i aktit nr. 17114, datë 15.9.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, për transferimin e përkohshëm të këtij nëpunësi në pozicionin “Përgjegjës Zyre, në Terminalin e Trageteve, Sektori i Operacioneve Doganore në Terminalin e Trageteve, Anijeve, Kontenierët”, Dega Doganore Durrës, është ndërprerë në momentin që ka dalë urdhëri i dytë për transferimin e përkohshëm (akti nr. 456, datë 11.1.2021) dhe me daljen e këtij akti ka filluar një afat i ri transferimi prej 6 muajsh. Në vijim të këtij arsyetimi, arrihet në

përfundimin se afati 6 mujor i transferimit të dytë, nuk është plotësuar akoma, prandaj me të drejtë institucioni ka mbajtur atë qëndrim në përgjigjen e tij.

Aktet e mësipërme, nga pikpamja procedurale janë të ligjshëm, pasi kanë dalë nga organi kompetent, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, siç parashikon pika 17, Kreu V, “*Transferimi i përkohshëm*”, e Vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për personelin e administratës doganore*”, i ndryshuar dhe është ruajtur edhe kategoria e pagës që ka patur në pozicionin e mëparshëm (*kategoria III-b*).

Megjithatë, kuptimi dhe zbatimi i kufizimeve të parashikuara në pikën 1, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duhet të mbahen parasysh nga ana e drejtuesit të institucionit dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, në çdo rast që kryejnë transferime të përkohëshme. Dispozitat e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, janë dispozita të një ligji kuadër, me karakter normativ, që shërbejnë për gjithë sistemin e shërbimit civil dhe menaxhimi korrekt i burimeve njerëzore, do të kërkonte zbatimin e harmonizuar të dispozitave të posaçme të Kodit Doganor, me parimet dhe rregullat e pranuar në legjislacionin e shërbimit civil.

Kjo do të thotë që, pavarësisht se në ligjin nr.102/2014, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, nuk është parashikuar shprehimisht kufizimi që transferimi i përkohshëm i një nëpunësi doganor nuk mund të lejohet për një kohë më shumë se 6 muaj gjatë dy vjetëve, kjo duhet të mbahet parasysh në mënyrë parimore nga menaxherët e burimeve njerëzore, në kuptimin që nëpunësi doganor mund të transferohet për një afat tjetër, në vazhdim apo me përsëritje, vetëm në kushtet e ekzistencës së nevojës së domosdoshme të argumentuar, duke përcaktuar saktë në akt afatet e transferimit dhe duke mbajtur parasysh parimet e proporcionalitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, parashikuar përkatësisht në nenet 12 e 17, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”.

Nga ana tjetër, bazuar në shkronjën “c”, pika 7, të nenit 15, të Kodit Doganor, në përfundim të afatit 6-mujor të transferimit të dytë, nëpunësi \*\*\*\*\*, duhet të kthehet në pozicionin e tij të rregullt të punës si “*Përgjegjës Turni në Sektorin Operacional/Terminal*”, Dega Doganore Rinas, si dhe të mbahet parasysh dhe të rregullohet situata në lidhje me administrimin e shërbimit civil nëse ky transferim i përkohshëm në pozicionin “*Specialist/Kordinator me DPD*”, Dega Doganore Durrës, është bërë jashtë organike.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në pikën 1, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në nenin 34, pika 1, të

Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

**VENDOSA:**

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 406 prot., datë 12.3.2021, të nëpunësit \*\*\*\*\*, në lidhje me pretendimet për parregullsi ligjore në kryerjen e transferimit të tij të përkohshëm dhe arkivimin e çështjes, duke i vënë në dukje njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, të respektojë parimet e shërbimit civil, siç është shprehur pjesa arsyetuese e këtij vendimi.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**